



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C. nr. 179/2013

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, në përbërje të kolegjit Atdhe Berisha, si gjyqtar profesionist, Rifat Gashi dhe Shemsidin Alibajro, si gjyqtar porotë, me procesmbajtëse Nazane Kuqani, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit N. B., nga Prizreni, Lagja, Rr. “...”, p.n., të cilin me autorizim e përfaqëson E.R., avokat nga Prizreni, kundër të paditurës G. K. , nga Prizreni, Rr. “...”, nr. .., për besimin, ruajtjen dhe edukimin e fëmijës së mitur, në seancën jopublike të shqyrtimit kryesor, me datë 15 Nëntor 2013, morri këtë:

A K T G J Y K I M

1. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit N. B. , me të cilën ka kërkuar:

“ Që fëmiju i mitur G. B. , e lindur me datë 20.01.2012, t’i besohet në ruajtje, kujdes dhe edukim të atit N. B., nga Prizreni, ashtu që të detyrohet e paditura G. Kt., t’i dorëzoj në ruajtje, kujdes dhe edukim paditësit N. B., në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nënë kërcënimin e përmbaramit të dhunshëm ” si kërkesë e pa themelt.

2. Detyrohet e paditura G. K., nga Prizreni, t’i mundësoj paditësit N. B., nga Prizreni, mbajtjen e kontakteve personale me të miturën G. B., nga Prizreni, ashtu që të dielën e parë dhe të tretë të muajit, paditësi N. B., të merr fëmijën e mitur G. B. nga e paditura G. K. , nga ora 09:00 deri në ora 17:00 dhe pas përfundimit të këtij orari fëmijën e mitur t’i dorëzon të paditurës G. K. . Si dhe gjatë festave të vitit të ri, gjegjësisht nga data 2 janar prej orës 10:00 deri më 3 janar në ora 15:00, për çdo vit, si dhe gjatë pushimeve verore nga 10 ditë, fëmijën e mitur G. B. , e paditura G. K. ti lejon paditësit N. B. që ta marr, dhe pas kësaj kohe, paditësi fëmijën e mitur t’i dorëzon të paditurës.

3. Detyrohet paditësi N. B. , në emër të kontributit për ushqimin e fëmijës së mitur, t’i paguaj fëmijës së mitur G. B. , përmes nënës së sajë këtu e paditura G. K. , nga 50,00 € në muaj, më së voni deri më datën 5 të muajit, nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, deri në ndryshimin e rrethanave nga të cilat është vendosur ky aktgjykim.

4. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi në padi dhe gjatë seancave gjyqësore, përmes të autorizuarit të tij, paraqet se nga bashkësia jashtëmartesore në mes ndërgjyqësve ka lindur me datë 20.01.2013 fëmija i mitur G. B. . Ndërgjyqësit nuk jetojnë në një bashkësi familjare, ngase paditësi është i martuar dhe jeton me bashkëshorten dhe fëmijët e tij. Ndërsa e paditura jeton në shtëpin e huaj, nuk është e punësuar dhe nuk ka mjete financiare për ekzistencën e vetë dhe për mbajtjen e fëmijës. Në anën tjetër paditësi është i punësuar, posedon shtëpi dhe ka mundësi që të kujdeset për fëmijën e mitur.

Më tej paditësi thekson se edhe raporti i Qendrës për Punë Sociale në Prizren, është i mendimit që fëmija t'i besohet paditësit pikërisht nga fakti se paditësi ka kushte më të mira financiare e paditura tërësisht është e varur prej paditësit si në aspektin e banimit duke pasur parasysh se e paguan qiranë e banesës, po ashtu edhe të ushqimit. Propozon që të aprovohet kërkesëpadia, shpenzimet procedurale nuk i kërkon.

E paditura gjatë seancës përgatitore thekson se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit, fëmijën e vetë dëshiron që ta rrit dhe të kujdeset vetë për të, në familjen e sajë. Nuk dëshiron që fëmija t'i besohet të atit. Njofton gjykatën që për seancat e radhës do t'i siguron provat gjegjësisht kontratën e punës.

Gjykata seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes e ka mbajtur në mungesë të palës së paditur, pasi që e paditura ka munguar në seancën e shqyrtimit kryesor, përkundër faktit se ka qenë e thirrur me rregull, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendje faktike, gjykata administroi provat dhe atë: me shikim në certifikatën e lindjes për fëmijën e mitur G. B. , me shikim në Akt Emërimin për N. B. , datë 04.01.2012, me shikim në formularin e pagesës për N. B. , nga data 01 Gusht 2013 deri më 31 Gusht 2013 sipas kodit ..-.....-..... dhe në Raportin e Qendrës për Punë Sociale në Prizren datë 29.05.2013.

Nga çmuarja me ndërgjegje dhe kujdes të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, si dhe nga rezultati i gjithë procedimit, gjykata vendosi që kërkesëpadia të refuzohet si e pabazuar.

Me shikim në certifikatën e lindje për të Miturën G. B. , vërtetohet se G. B. , ka lindur me datë 20.01.2012, në Prizren, nga i ati N. B. , këtu paditësi dhe e ëma G. K. , këtu e paditura.

Me shikim në Akt Emërimin e datës 04.01.2012, vërtetohet se këtu paditësi me datë 01.04.2012 është emëruar Inspektor Komunal, në Drejtorinë e Inspektoratit Komunal, në Komunën e Prizrenit, në kohëzgjatje të afatizuar, grada e të cilit përmban koeficientin 6.

Me shikimin në formularin e pagesave sipas kodit ..-..... -..... , nga data 01 Gusht 2013 deri më datë 31 Gusht 2013, vërtetohet se këtu paditësi N. B. , ka realizuar të ardhura personale në shumën, € , si pagë bruto duke paguar, € për pension dhe, € për tatim, gjithësejt, € pagë neto, për vendin e punës inspektor komunal, në Komunën e Prizrenit.

Me leximin e raportit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Prizrenit, të datës 29.05.2013, vërtetohet se Qendra për punë Sociale pas hetimit të rrethanave ku ka përfshi intervistimin e palëve ndërgjyqëse, gjendjen financiare të tyre dhe hapësirën banesore, ka dhënë rekomandim që fëmija i mitur t'i besohet të atit këtu paditësi N. B. .

Me rastin e vendosjes në këtë çështje, gjykata një rendësi të posaçme i kushtoi raportit të Qendrës për Punës Sociale të datës 29.05.2013. duke vlerësuar rëndësinë e mendimit profesional të Qendrës për Punës Sociale, në të gjitha seancat gjyqësore, gjykata ka ftuar menaxhuesin e këtij rasti pran Qendrës për Punës Sociale, nga edhe ka kërkuar informata lidhur me hetimin dhe kriteret që janë marr për bazë, lidhur me sqarimin e rrethanave që kanë qenë më rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës, kur kanë propozuar që fëmija t'i besohet të atit këtu paditësit N. B. .

Nga sqarimit të cilat ka dhënë menaxhuesi i rastit pran Qendrës për Punë Sociale, kriteri kryesor dhe i vetëm i cili është marr për bazë ka qenë mundësit financiare që ka pas paditësi për zhvillimin e drejt psikik, fizik dhe për edukimin e fëmijës. Një ndër arsyet të cilat jep menaxhuesi i rastit ka qenë se *“nëse fëmija do t'i besohet të ëmës do të krijonim rast social”*.

Gjykata vlerëson se për të pranuar propozimin e Qendra për Punës Sociale të Komunës së Prizrenit, kjo e fundit është dashur t'i hetojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik, ashtu siç kërkon neni 154 par. 1 të Ligjit për Familjen, e jo propozimin e sajë ta bazon vetëm në gjendjen financiare të prindërve, duke mos marr për bazë rrethanat tjera.

Gjendja materiale nuk duhet të merret apriori si rrethanë kryesore për të cilën ndonjëri nga prindërit e fëmijës do të përjashtohet me rastin e vendosjes lidhur me besimin e fëmijës së mitur. Me vetë faktin se gjendja materiale e prindërve ashtu siç parashihet edhe në nenin 203 par. 4 të Ligjit Për Familjen, nuk mund të jetë bazë për vendosjen e fëmijës në familjen tjetër, aq më tepër gjendja material si e vetme nuk mund të merret si kriter kryesor që ndonjëri nga prindërit, me gjendje jo të mirë materiale, të mos i besohet fëmija në ruajtje dhe edukim. Mbi këtë rrethanë, gjykata nuk i kushtoi besimi raportit të Qendrës për Punë Sociale të Komunës së Prizreni.

Mosha në të cilën ndodhet fëmija i mitur, gjegjësisht mosha prej 23 muajsh e fëmijës së mitur, ka nevoja specifike, të cilat nevoja kjo gjykatë konsideron se më së miri do ti përmbushte e ëma e fëmijës, këtu e paditura G. K. . Pikërisht duke pasur parasysh moshën e fëmijës, do të ishte e dëmshme në aspektin psikik tani për tani për fëmijën e mitur që të ndërronte ambientin familjar, nëse do të shkonte të jetonte në familjen e të atit N. B. . Në këtë moshë fëmija është shumë e lidhur me të ëmën duke pas parasysh kujdesin që kërkon fëmija për atë moshë dhe do të ishte shumë vështirë tani për tani që fëmija e mitur G. B. , të krijonte raportin familjar me familjen e të atit dhe të ambientohej me. Gjykata konsideron se kujdesi prindëror nga e ëma në këtë moshë të fëmijës, është esencial për një zhvillim të drejtë psikik dhe fizik.

Sa i përket kontakteve të të atit këtu paditësi N. B. me fëmijën e mitur, gjykata pati parasysh krijimin e raportit familjar në mënyrë graduale. Gjykata me rastin e rregullimit të kontakteve të fëmijës me të atin, ka rregulluar në atë mënyrë kontaktet e fëmijës me familjen e të atit, ku si qëllim kryesor ka qenë, që duke pas parasysh kohën dhe mënyrën e kontakteve, fëmija e mitur të adoptohet në rrethin e ri familjar i cili do të ndikonte në zhvillimin e drejtë psikik dhe në edukimin e fëmijës së mitur.

Lidhur me vendimin me të cilën gjykata ka caktuar lartësinë e ushqimit për fëmijën e mitur, gjykata ka pas parasysh nevojat e fëmijës së mitur për moshën që ka, gjithnjë duke pasur parasysh gjendjen pasurore të të atit të fëmijës, Gjithashtu ka marr për bazë mundësin dhe zotësinë për punë nga ana e të ëmës së fëmijë. Nevojat e fëmijës së mitur nuk janë aq të mëdha për moshën që ka. Mundësit financiare të të atit të fëmijës, këtu paditësit N. B. , nuk janë të atij niveli për një shumë më të madhe se 50,00 € për fëmijën e mitur. fakti se këtu paditësi jeton vetë i pesti me një pagë mujore neto prej, € ku dy nga fëmijët e tij janë student, paraqet një rrethanë

të tillë që nëse gjykata do të vendoste për një shumë më të lartë, do të rrezikohej ekzistenca e familjes së paditësit. Duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana gjykata konsideron se shuma prej 50.00 € për ushqimin e fëmijës së mitur është e mjaftueshme dhe nuk do të rrezikonte mirëqenien e familjes së këtu paditësit N. B. .

Për shpenzimet e procedurës, u vendos konform nenit 452 par. 1 lidhur me nenin 463 të LPK-së, pasi që pala e paditur nuk ka kërkuar shpenzimet procedurale në mënyrë të specifikuar, përkundër faktit se ky aktgjykim është në favor të sajë.

Nga arsyet e cekura më lartë si dhe në kuptim të nenit 140 par. 2 lidhur me nenin 144 par. 1 të Ligjit për Familjen i Kosovës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 173/2013 datë 15 Nëntor 2013

Procesmbajtësja
Nazane Kuqani

Gj y q t a r i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi.